



PROGRAMI I PUNËS I KANDIDATIT PËR REKTOR TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

PERIUDHA KOHORE 2023-26



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

PROGRAMI I PUNËS I KANDIDATIT PËR REKTOR TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS PERIUDHA KOHORE 2023-26

I. Hyrje

Ky program pune është ndërtuar brenda kornizës dhe në harmoni të plotë me vizionin dhe misionin e Universitetit. Universiteti i Tetovës, si qendër e dijes, edukimit, kërkimit si dhe angazhimit në komunitet, përkrah jetësimin të idealeve kombëtare dhe vlerave bashkëkohore në arsim, kulturë e shkencë me qëllim të zhvillimit dhe përparimit të gjeneratave të reja, mban mbi supe përgjegjësi të konsiderueshme për nxitjen e krijimit, zhvillimit dhe avancimit të kompetencave akademike, por edhe profesionale të mësimit dhe studentëve të tij. Nëpërmjet roleve të shumanshme që ka, Universiteti i Tetovës do të jetë i orientuar të kontribuojë në ndryshimet shoqërore duke nxitur inovacione dhe duke formësuar të ardhmen nëpërmjet përgatitjes së të rinjve që të jenë liderë, krijues të ndryshimeve dhe kontribues për një shoqëri më të mirë si në rrafshin kombëtar edhe në atë ndërkombëtar.

Njohja dhe pranimi i rolit kyç të mësimit dhe studentëve si promotorë të zhvillimit të proceseve, e etablojnë Universitetin e Tetovës si nxitës të ndryshimeve pozitive e kontribues për një të ardhme të begatë dhe të qëndrueshme për të gjithë. Përkrah avancimit të thirrjeve akademike, do të ofrohen mekanizma mbështetëse dhe mundësi të shumta për të rritur kompetencat e mësimit dhe studentëve, por edhe për zhvillim akademik dhe profesional të tyre.

Kultivimi i vlerave etike, barazisë, integritetit, promovimit të diversitetit, standardit studentor dhe tolerancës janë objektivat parësore të Universitetit. Ne jemi të orientuar të ofrojmë shërbime gjithëpërfshirëse për përkrahje të studentëve për të krijuar një mjedis mbështetës që ushqen mirëqenien, angazhimin dhe suksesin e studentëve. Jemi të vendosur që të sigurojmë qasje të barabartë dhe arsim cilësor për të gjithë, por edhe mundësi të barabarta për zhvillim kompetencash profesionale si dhe për përfshirje aktive në organet vendimmarrëse.

Forcimi dhe krijimi i vazhdueshëm i bashkëpunimeve dhe partneriteteve me institucione akademike, palë të interesit relevant si kompani, institucione kulturore, organizata qeveritare dhe joqeveritare nacionale e ndërkombëtare do të fuqizojë angazhimin e komunitetit tonë universitar në projekte të përbashkëta kërkimore por edhe programe shkëmbimi. Këto nisma lehtësojnë transferimin e njohurive dhe përvojave për mësimit dhe studentët, duke i ekspozuar ndaj perspektivave të ndryshme dhe praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Vazhdimi i mbështetjes së një mjedisi që promovon veprimtarinë mësimore-shkencore, digjitalizimi i shërbimeve, kontribuon në avancimin e njohurive dhe rrjedhimisht e rrit reputacionin akademik të Universitetit tonë.

Ndërlidhja e mësimit akademik me aplikimin e njohurive në botën reale do të arrihet përmes avancimit të metodave të mësimdhënies dhe mbështetjes së kulturës së kërkimit në Universitet, mësimit praktik, akreditimit të laboratorëve ekzistues, si dhe duke shpërndarë burime dhe stimuj për ndërmarrje të projekteve kërkimore.

Pas 28 vjetësh punë të pandalshme, Universiteti i Tetovës është shndërruar në qendër të mirëfilltë edukimi e arsimimi, jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, por edhe në rajon. Shumëllojshmëria e programeve të studimit është një element kryesor, që na dallon ne si Universitet. Si një universitet shumëdisiplinor, Universiteti i Tetovës zotëron potencial të shkëlqyeshëm për të bërë kërkime inovatore si dhe për të promovuar zbatimin e tyre në tregun e punës dhe jo vetëm.

Ky program synon të paraqesë zhvillimin 3-vjeçar të Universitetit, në të cilin fokus dhe orientim kryesor janë pesë prioritetet strategjike, edhe atë:

- 1. Zhvillimi akademik dhe sigurimi i cilësisë**
- 2. Standardi dhe mirëqenia studentore**
- 3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi akademik**
- 4. Kërkimi shkencor, infrastruktura universitare, TI dhe digjitalizimi**
- 5. Përgjegjësia sociale dhe angazhimi me komunitetin**



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

II. Prioritetet strategjike

1. Zhvillimi akademik dhe sigurimi i cilësisë

Njëri nga synimet kryesore do të jetë përforcimi dhe ngritja e mekanizmave për të rritur cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara nga Universiteti, njëkohësisht duke zbatuar standardet nga udhëzuesi i sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në hapësirat evropiane. Procesi i sigurimit të cilësisë fokusohet në të nxënit e studentëve duke rritur cilësinë e programeve të studimit, zhvillimin akademik si dhe kujdesin për mirëqenien e standardit studentor.

Në këtë drejtim, i rëndësishëm së veçantë po ashtu do të jetë edhe përcaktimi i detajuar i përmasave të zhvillimit akademik të stafit akademik dhe studentëve, duke përforcuar kompetencat dhe shkathtësitë akademike dhe profesionale në fushat përkatëse studimore në koherencë të plotë me kërkesat dhe zhvillimet shkencore të kohës, me qëllim të zbatimit të standardeve, normave dhe rregullave organizative për realizimin e veprimtarisë së arsimit universitar.

Për realizimin e këtij prioriteti strategjik, thelbësore janë: përforcimi i lirisë akademike, duke kultivuar lirinë e shprehjes dhe mendimin kritik, liria në punën kërkimore-shkencore si dhe aplikimi i gjetjeve të kërkimit shkencor, kujdesi dhe mbrojtja e avancimit të studentëve dhe të të punësuarve, furnizimi dhe avancimi i mjeteve dhe përmbajtjeve të teksteve mësimore, dhënia e titujve akademikë dhe shkencorë sipas ligjit, si dhe përkrahja e zhvillimit profesional në përzgjedhje të pozitave mësimore-shkencore në të gjitha fazat e përcaktuara sipas ligjit, duke respektuar barazinë akademike dhe mosdiskriminimin e të gjithëve përballë kriterëve, të cilat e sigurojnë cilësinë.

Zhvillimi akademik

Fryma e suksesit të një universiteti është forcimi dhe zhvillimi i kompetencave të duhura profesionale të stafit akademik dhe studentëve, si një ndër komponentat kryesore të misionit që e ka universiteti. Zhvillimet shkencore në këtë kohë janë të shumta dhe ndryshimet në kërkesat e kompetencave dhe shkathtësive akademike janë të pandalshme, andaj nevoja për t'u përshtatur me këto ndryshime si e stafit akademik, programeve studimore dhe kompetencave të studentëve është domosdoshmëri për funksionimin e veprimtarisë së Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Zhvillimi akademik është i lidhur fort dhe pozitivisht me lirinë akademike dhe mendimin kritik, duke pasur mundësi që stafi akademik dhe studentët me liri të plotë dhe mbështetje institucionale ta realizojnë punën kërkimore-shkencore, të jenë të furnizuar mirë me mjete pune dhe përmbajtje të teksteve më të avancuara mësimore, duke përparuar në vazhdimësi në grada akademike dhe shkencore, njëherësh duke respektuar saktë kriteret e përzgjedhjes së pozitive të ndryshme mësimore, me garanci të plotë për barazinë akademike.

Dekadën e fundit në Universitetin e Tetovës stafi akademik është zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore brenda afateve të caktuara ligjore dhe është përkrahur në zhvillimin e kompetencave akademike nëpër trajnime, konferenca shkencore dhe projekte të ndryshme, duke ua dhënë mundësinë që të jenë pjesë e të gjitha aktiviteteve në kuadër të Universitetit, gjegjësisht njësive akademike. Liria akademike dhe e shprehjes kanë qenë pjesë e rëndësishme e krijimit të kurrikulave mësimore, përdorimin e literaturës dhe realizimin e të gjitha planeve mësimore dhe është trajtuar drejt dhe pa dallim gjinie, etnie, përkatësie religjioze dhe moshe. Sistemi elektronik ka mundësuar digjitalizimin e dokumenteve, mësimin, vlerësimin dhe punimeve shkencore e si rrjedhojë është lehtësuar puna administrative e stafit akademik.

Maksimalizimi i funksionit të njësive akademike në vendimmarrje dhe përfshirja e barabartë e stafit në aktivitete të ndryshme të institucionit, avancimit në thirrje mësimore-shkencore, barabarësi gjatë pagesave për punën akademike dhe përfshirja vullnetare dhe normative e stafit akademik ka qenë një ndër përparësitë e fuqishme gjatë viteve. Universiteti është angazhuar në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve studimore, duke zhvilluar dhe rishqyrtuar kurrikulat për t'u siguruar se ato përmbushin standardet më të fundit arsimore.

Programet studimore aktuale janë përpiluar duke marrë parasysh rekomandimet e studimit të tregut për kompetenca të punonjësve të ardhshëm. Në këtë drejtim është siguruar përpilim i programeve studimore të harmonizuara me kërkesat e tregut. Në proces të akreditimit të programeve studimore në ciklin e parë, dytë dhe tretë, stafi akademik ka qenë i përfshirë në dizajnimin e të gjitha përmbajtjeve mësimore-shkencore, në përputhje me fushat përkatëse në të cilat janë zgjedhur.

Në fillimin e mandatit trevjeçar do të inicohet një diskutim për çdo fushë të identifikuar për përmirësim për të promovuar planifikim afatgjatë dhe qëndrueshmëri, por edhe të lundrohet në sfidat dhe të shfrytëzohen mundësitë për rritje dhe sukses. Zhvillimi i strategjisë 10-vjeçare të Universitetit do të kanalizonte vendimet dhe veprimet për të arritur misionin dhe vizionin e Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Përkundrejt zhvillimit pozitiv të institucionit dhe njësive akademike të saj nevojitet intervenim në stimulim dhe rritje të kompetencave të stafit akademik për realizimin e procesit mësimor-shkencor, por edhe të rritjes së prevalencës së aktiviteteve studentore që të mundësohet sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe ruajtjes së standardeve të larta akademike. Fokusi ynë gjatë trevjeçarit të ardhshëm do të jetë në adresimin e barrierave me të cilat përballet komuniteti akademik i gjinisë femërore në Universitet për të krijuar drejtime për avancimin e tyre profesional brenda Universitetit.

Plani i veprimit në mandatin trevjeçar:

- Kultivimi i autonomisë universitare dhe lirisë akademike;
- Avancimi i kushteve për realizimin e procesit mësimor-shkencor në të gjitha njësitë akademike duke shfrytëzuar maksimalisht të gjitha hapësirat e Universitetit dhe krijimi i hapësirave të reja;
- Krijimi i programeve shumëdisiplinore sipas standardeve bashkëkohore;
- Akreditimi i programeve me diploma të dyfishta (Joint Degree);
- Akreditimi i programeve studimore profesionale (60-120 ECTS) të harmonizuara me universitete evropiane;
- Roli aktiv në përpjekjet për sigurimin e rregullave dhe kriterëve të qarta për financimin e arsimit të lartë në institucionet e arsimit të lartë publik në vend dhe sigurimin e autonomisë financiare për universitetet publike;
- Sigurimi i pagave më të mira nga mjetet buxhetore për punonjësit për veprimtarinë kërkimore-shkencore të Universitetit;
- Plotësimi i vendeve të punës me kuadër kompetent akademik dhe përpjekja e vazhdueshme për zgjidhjen e statusit të stafit të angazhuar me kohë të pjesshme në Universitet;
- Avancimi në thirrje mësimore-shkencore duke respektuar kriteret dhe procedurat ligjore dhe administrative;
- Përfshirja e stafit të dëshmuar nga vendi dhe jashtë për ndarje të eksperiencave akademike;
- Ofrimi i mundësive për zhvillim profesional të stafit akademik në drejtim të përdorimit të metodave të avancuara të mësimdhënies përmes trajnimeve për zhvillimin e shkathtësive akademike;
- Përcaktimi i saktë i koeficientit të performancës akademike për stimulim dhe motivim;
- Mentorimi dhe mbështetja e stafit të ri;
- Përforsimi i kapaciteteve të menaxhimit të burimeve njerëzore të Universitetit;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- Mbështetja për aftësim dhe përsosje të vazhdueshme të stafit administrativ;
- Sigurimi i literaturës bashkëkohore;
- Promovimi i barazisë gjinore duke inkurajuar avancimin e grave në pozita udhëheqëse në njësitë akademike, qendrat e Universitetit dhe pozitat administrative;
- Avancimi i programeve të shkëmbimit të stafit dhe studentëve;
- Organizimi i trajnimeve të ndryshme me qëllim të rritjes së kompetencave të stafit akademik për përpilim të punimeve shkencore cilësore;
- Përfshirja e studentëve të dalluar në punën mësimore;
- Përkrahja e punës praktike të studentëve dhe rritja e kapaciteteve teknike laboratorike, për realizimin e ushtrimeve të ndryshme në kuadër të shumë programeve studimore.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Sigurimi i cilësisë

Kultura e cilësisë në Universitet, si imperativ i kohës, ndihmon në rrënjosjen e krenarisë, pronësisë dhe përgjegjësisë kolektive të të gjithë anëtarëve të komunitetit akademik si dhe kontribuon në rritjen e cilësisë dhe reputacionin e përgjithshëm të institucionit. Zhvillimi i kësaj kulture i artikuluar në të gjitha fushëveprimet e të gjithë anëtarëve të komunitetit akademik, e përforcojnë jetësimin e misionit dhe qëllimeve të Universitetit, duke e pasqyruar si promotor të ndryshimeve në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Tendenca për sigurim të cilësisë në Universitet është e njohur përmes realizimit të një sërë aktiviteteve funksionale në dhjetëvjeçarin e fundit. Themelimi i Zyrës për menaxhim me cilësi dhe evaluim ka mbështetur në vazhdimësi vlerësimin e cilësisë në Universitet, të realizuar përmes procedurave për vlerësim të programeve studimore dhe stafit akademik bazuar në veprimet dhe standardet për sigurimin e cilësisë të miratuara me Ligjin për arsim të lartë si dhe nga institucionet evropiane gjegjëse. Tanimë, në çdo njësi akademike të Universitetit, përmes procesit të vetevaluimit është siguruar respektimi i vazhdueshëm i standardeve për cilësi. Vetevaluimi i njësive akademike të Universitetit si dhe realizimi i evaluimit të jashtëm janë treguesit e zotimit për rritje dhe avancim të cilësisë së Universitetit.

Komisioni qendror për vetevaluim si dhe komisionet e njësive akademike në periudhë ciklike trevjeçare realizojnë vlerësim të programeve studimore, stafit akademik, procesin mësimor-shkencor si dhe infrastrukturën e njësive. Të dhënat, së bashku me vlerësimin e studentëve nëpërmjet anketimit, i cili përfshin komponentët e paraparë në Ligjin për arsim të lartë si dhe Statutin e Universitetit shërbejnë si pika referuese për avancim të cilësisë së institucionit.

Plani i veprimit në mandatin trevjeçar:

- Fuqizimi dhe qëndrueshmëria e kulturës së cilësisë në drejtim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë profesionale dhe studentore;
- Përpilimi i strategjisë dhjetëvjeçare të Universitetit;
- Implementimi i standardeve të pranuar ndërkombëtarisht në fushën e cilësisë;
- Vazhdimi i vetevaluimit të brendshëm (të njësive akademike dhe Universitetit) dhe organizimi i evaluimit të jashtëm;
- Përditësimi dhe përshtatja e instrumenteve matëse të cilësisë;
- Avancimi i metodave dhe strategjive të mësimdhënies si dhe mjeteve/materialeve didaktike bashkëkohore;
- Përmirësimi i pozitës në rang listat ndërkombëtare;
- Sigurimi i vlerësimit efektiv të rezultateve të të nxënimit të studentëve;
- Promovimi i ditës së cilësisë së Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

2. Standardi dhe mirëqenia studentore

Ne synojmë ngritjen e standardit studentor, cilësinë e jetës studentore dhe studimeve, në të gjitha sferat e përcaktuara në Ligjin për arsim të lartë dhe Statutin e Universitetit që do të mundësojnë hapërimin e rregullt gjatë studimeve.

Ky objektivi njëherësh përfshin të gjitha standardet e vendosura për të siguruar cilësinë e jetës së studentëve gjatë studimeve. Segmentet kryesore që kërkojnë vëmendje janë mekanizmat e menaxhimit institucional dhe të njësive akademike, respektimi i dinjitetit dhe personalitetit të studentit nëpër të gjitha fazat e studimit, mbështetja me bursa, përfshirja në proceset vendimmarrëse të Universitetit dhe në shfrytëzimin e të dhënave shkencore, librave, hapësirës, pajisjeve profesionale dhe infrastrukturës universitare janë tregues të fortë për një standard të lartë studentor.

Përgjatë 10 vjetëve të kaluara, Universiteti i Tetovës, ka përkrahur me bursa studentët e ciklit të parë dhe dytë, duke i liruar nga pagesa e studimeve. Krahas **bursave për studentë ekselentë**, po ashtu Universiteti ka siguruar bursa edhe për kategoritë e mëposhtme:

- raste sociale,
- fëmijë pa prindër,
- invalidë të luftës,
- fëmijë nga prindër me shkallë të caktuar të invaliditetit,
- studentë me aftësi të kufizuara, etj.

Në vazhdimësi, studentëve iu është siguruar udhëtimi për punë praktike brenda dhe jashtë vendit, qasje në organet vendimmarrëse dhe në të gjitha hapësirat e Universitetit. Ata janë përfshirë në aktivitete shkencore dhe rekreative jashtëmësimore. Në masë të madhe i është kushtuar rëndësi respektimit të të drejtave gjatë procesit mësimor, vlerësimit të njohurive dhe trajtimit të barabartë të shprehjes së ankesave.

Studentëve u është lehtësuar procesi i komunikimit me Universitetin, ndërsa përmes platformës “Kujdesi për Ty”, ata kanë pasur të drejtë të denoncojnë të gjitha çështjet që lidhen me ruajtjen dhe kultivimin e dinjitetit dhe integritetit të tyre individual. Përmes marrëveshjeve të ndryshme ndër-institucionale u janë siguruar bursa shtesë, mundësi për punësim si dhe mbështetje në zhvillimin e mëtutjeshëm të karrierës.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Plani i veprimet në mandatin trevjeçar:

- Rritja e mundësive për edukimin gjithëpërfshirës, barazi, mosdiskriminim dhe promovim të kompetencave qytetare;
- Kujdesi ndaj dinjitetit të studentit në të gjitha kontekstet e mundshme gjatë studimeve dhe avancimi i mekanizmave institucionale për mbrojtjen e studentit;
- Vazhdimi i mbështetjes me bursa për studentët e dalluar dhe të kategorive tjera sociale dhe rritja e burimeve për mbështetjen e studentëve;
- Angazhimi për një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës brenda kampusit universitar;
- Bashkëveprimi me të gjitha institucionet për ta përmirësuar standardin studentor;
- Mbështetja e funksionimit të organeve të parlamentit studentor;
- Programi orientues gjithëpërfshirës për studentët e rinj (informacione në lidhje me kampusin, shërbimet mbështetëse, kërkesat akademike dhe mundësitë për aktivitete jashtëmësimore);
- Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive të ndryshme si dhe mundësimi i mësimin tutorial;
- Ofrimi i mundësive për zhvillim personal dhe profesional për të gjithë studentët, duke përfshirë kapacitetet e Qendrës për karrierë;
- Avancimi i kushteve të përshtatshme për përfshirje në studime për studentët me aftësi të kufizuara;
- Ndjekja e zhvillimit profesional përmes asociacionit ALUMNI duke i përfshirë të diplomuarit në të gjitha ciklet;
- Përfshirja e studentëve në aktivitete sportive, ku përkrah klubeve aktuale do të themelohen edhe klubet e futbollit, basketbollit dhe shahut;
- Përfshirja e studentëve në aktivitete kulturore përmes themelimit të Skenës Studentore të Universitetit të Tetovës me program të rregullt artistik me shfaqje, ekspozita, koncerte, instalacione, projekte multimediale etj.;
- Rritja e mundësive dhe mbështetja për realizimin e praktikës studentore;
- Mbështetja e projekteve hulumtuese, revistave, konferencave si dhe aktivizimit studentor;
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore përmes funksionalizimit të poliklinikës studentore;
- Orientimi profesional i studentëve në fusha të caktuara shkencore të nevojshme për institucionin dhe shoqërinë;
- Rritja e impaktit social dhe përgjegjësisë sociale;
- Programi i orientimit dhe mbështetjes së studentëve të huaj;
- Përfshirja e studentëve në zhvillimin e kurrikulave mësimore;
- Sigurimi i parakushteve për realizimin e mësimin në distancë.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Arritja e këtyre qëllimeve dhe objektivave do të përcaktohet në bazë të përpilimit të planeve aksionare duke i përcaktuar realizuesit, aktivitetet dhe afatin e realizimit, si dhe në partneritet të plotë me Agjencinë për Cilësi në Arsimin e Lartë, Asociacionin e Universiteteve Evropiane, Magna Carta, Këshillin Nacional për Arsimin e Lartë, Agjencinë për Akreditim, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ministritë dhe institucionet e ndryshme shtetërore, klinikat dhe spitalet shtetërore dhe private, institucionet arsimore në vend dhe jashtë, kompanitë private, organizatat (jo)qeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare, duke avancuar dhe e ripërtërirë bashkëpunimin.

Këto procese do të monitorohen përmes përpilimit të një skeme për përcjelljen dhe evaluimin e të gjitha hapave të realizimit të qëllimeve dhe objektivave, mbikëqyrjen e vazhdueshme të implementimit të të njëjtave. Formimi i ekipeve kompetente në përputhje me natyrën e qëllimeve dhe objektivave, do të jenë mekanizmat kryesore për të bërë vlerësimin dhe monitorimin e këtyre arritjeve.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi akademik

Historia e Universitetit të Tetovës është dëshmi e rolit vendimtar që ka luajtur bashkëpunimi ndërkombëtar në zhvillimin dhe rritjen e tij. Ndër vite, Universiteti i Tetovës ka krijuar partneritete dhe bashkëpunime me universitete dhe organizata të shumta në mbarë botën. Këto bashkëpunime kanë lejuar Universitetin të ketë qasje në burime dhe ekspertizë që përndryshe mund të mos ishin të disponueshme, si dhe të ndajë njohuritë dhe përvojën e vet të veçantë me tjerët. Nëpërmjet projekteve të përbashkëta kërkimore, programeve të shkëmbimit akademik dhe nismave të tjera, Universiteti ka mundur të zgjerojë horizontet dhe të thellojë ndikimin e tij, si në nivel lokal ashtu edhe më gjerë.

Për një universitet të vendosur në Maqedoninë e Veriut, një shtet në prag të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është vetëm një imperativ strategjik, por edhe një imperativ moral. Përveç kësaj, bashkëpunimi ndërkombëtar i ka mundësuar Universitetit të Tetovës të tërheqë dhe të mbajë pedagogë dhe studentë të talentuar nga e gjithë bota, duke rritur diversitetin dhe gjallërinë e komunitetit të tij akademik. Universiteti ka qenë në gjendje të nxisë një ndjenjë të qytetarisë globale demokratike dhe të përgatisë të diplomuarit e tij që të lulëzojnë në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur. Ne njohim gjithashtu fuqinë transformuese të shkëmbimit kulturor, si një mjet për të promovuar mirëkuptimin, tolerancën dhe respektin e ndërsjellë. Duke u angazhuar me njerëz nga kultura, prejardhje dhe perspektiva të ndryshme, ne zgjerojmë horizontet tona dhe fitojmë një kuptim më të nuancuar të botës përreth nesh.

Në këtë kontekst, ne e shohim bashkëpunimin ndërkombëtar si një vlerë thelbësore që mbështet misionin dhe vizionin tonë institucional. Ne jemi të përkushtuar për të ndërtuar një kulturë bashkëpunimi, inovacioni dhe përsosmërie që i kapërcen kufijtë kombëtarë dhe nxit krijimin e njohurive, ideve dhe partneriteteve të reja. Duke përqaftuar këtë vizion dhe duke punuar në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë, ne synojmë të japim një kontribut pozitiv për komunitetet tona, vendin tonë dhe botën në përgjithësi.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një shtyllë kyçe e misionit dhe vizionit të Universitetit të Tetovës. Nëpërmjet partneriteteve të tij me universitete në mbarë botën, ai po kontribuon në zhvillimin e një rajoni më paqësor, më të qëndrueshëm dhe më të begatë, duke promovuar gjithashtu përsosmërinë akademike, mirëkuptimin ndërkulturor dhe ruajtjen e gjuhës dhe kulturës.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Tashmë kemi krijuar partneritete me institucione prestigjioze perëndimore dhe jo vetëm, dhe jemi të përkushtuar të ndërtojmë këto marrëdhënie ndërsa ecim përpara. Jemi pjesë e një Aleance Universitare Evropiane-AURORA dhe rrisim për çdo ditë marrëveshjet bilaterale ndëruniversitare në kuadër të platformës Erasmus+.

Gjatë periudhës trevjeçare të mandatit të Rektorit, ne do të fokusohemi në disa fusha kyçe për të forcuar dhe përmirësuar përpjekjet tona për ndërkombëtarizim, përmes *zhvillimit të partneriteteve të reja, pjesëmarrjes në programet e arsimit të lartë në mbarë Bashkimin Evropian* (Erasmus+, Horizon Europe, COST, etj.), *pjesëmarrjes aktive në programet e arsimit të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Fulbright, SUSI, JFDP), dhe mbështetjes së programit/aktiviteteve të Këndit Amerikan në UT, vazhdimin të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në programet e EUA-së dhe programeve të tjera globale të arsimit të lartë të mbështetura nga Observatory Magna Charta Universitatum, BUA, BSUN, EAAE/AEEA, ELFA, etj.*

Bashkëpunim me universitete mbarëkombëtare

Ne e njohim rëndësinë e bashkëpunimit me universitete të tjera që ndajnë gjuhën dhe kulturën tonë. Ne besojmë se duke punuar së bashku, ne mund të arrijmë përsosmëri më të madhe akademike dhe të forcojmë angazhimin tonë të përbashkët për të promovuar gjuhën dhe kulturën tonë në skenën ndërkombëtare.

Krijimi i programeve të përbashkëta akademike, iniciativa kërkimore dhe programe të shkëmbimit të studentëve dhe stafit janë vetëm disa nga elementet e bashkëpunimit me universitetet simotra. Duke punuar së bashku, ne mund të krijojmë një rrjet të fortë universitetesh shqipfolëse, që mund të konkurrojnë në skenën globale dhe të promovojnë gjuhën dhe kulturën tonë në një audiencë më të gjerë.

Marrja e një roli udhëheqës në kultivimin dhe kujdesin e gjuhës dhe kulturës sonë

Si qendra kryesore e angazhimit kombëtar në avancimin dhe ushqimin e gjuhës dhe kulturës sonë, ne besojmë se është përgjegjësia jonë të marrim një rol udhëheqës në promovimin e gjuhës dhe kulturës sonë si në kampus ashtu edhe në komunitetin e gjerë. Ne do të punojmë për të krijuar partneritete me organizata kulturore dhe arsimore që ndajnë vlerat dhe misionin tonë dhe do të kërkojmë mundësi për të promovuar gjuhën dhe kulturën tonë në skenën ndërkombëtare.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Mbajtja dhe tërheqja e profesorëve ndërkombëtarë

Rëndësia e tërheqjes dhe mbajtjes së talentëve të spikatura ndërkombëtare në fusha të ndryshme për të ndërtuar kapacitete dhe kapital njerëzor, duke kërkuar në mënyrë aktive profesorë dhe studiues të njohur në të gjitha fushat shkencore.

Misioni i kthimit të trurit (Brain Gain)

Kthimi i trurit është një komponent kritik i strategjisë sonë të ndërkombëtarizimit pasi na mundëson të përmirësojmë cilësinë e kërkimit dhe mësimdhënies sonë, si dhe të pasurojmë komunitetin tonë akademik. Qëllimi ynë është të krijojmë një mjedis që është i favorshëm për të tërhequr dhe mbajtur mendjet më të mira dhe më të ndritura nga e gjithë bota, duke ushqyer gjithashtu talentet dhe potencialin e studentëve dhe stafit tonë.

Në përgjithësi, strategjia jonë e kthimit të trurit do të udhëhiqet nga parimet e përsosmërisë, gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit dhe do të jetë një shtytës kryesor i përpjekjeve tona për të avancuar institucionin tonë dhe vendin tonë në skenën globale.

Plani i veprimit në mandatin trevjeçar

- Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse ndërkombëtarizimi që përfshin një analizë të detajuar të gjendjes aktuale, identifikimin e fushave të përmirësimit dhe objektivat specifike për zhvillimin e ardhshëm;
- Nisja e një fushate të synuar enkas për rekrutimin e profesorëve të mirënjohur dhe shumë të arrirë;
- Rritja e kapaciteteve të Zyrës për marrëdhënie me jashtë, për të mbështetur zhvillimin dhe administrimin e programeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare;
- Rritja e marrëveshjeve ndër-institucionale në kuadër të platformës Erasmus+ me institucione prestigjioze evropiane;
- Rritja e fondeve të programit për mobilitet të stafit dhe studentëve në kuadër të Erasmus+;
- Rritja e numrit të profesorëve amerikanë që do të qëndrojnë në Universitetin tonë në kuadër të programit Fullbrajt dhe Fullbrajt Specialist;
- Jetësimi i Asociacionit të Universiteteve Publike Shqiptare (AUPSH) që synon lehtësimin e kërkimit të përbashkët, shkëmbimin e pedagogëve dhe studentëve dhe forma të tjera bashkëpunimi;
- Krijimi i një programi gjithëpërfshirës të kthimit të trurit;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- Rekrutimi i anëtarëve të stafit akademik ndërkombëtar me ekspertizë në fusha që do të na ndihmojnë të ndërtojmë kapacitete dhe kapital njerëzor;
- Organizimi i ngjarjeve ndërkombëtare, konferencave dhe seminareve që fokusohen në ngritjen e imazhit të Universitetit, përmes promovimit të arritjeve më të fundit kërkimore-shkencore të stafit dhe studentëve të UT-së;
- Rritja e profilit ndërkombëtar të universitetit tonë duke marrë pjesë në rangimet ndërkombëtare, duke shfaqur përsosmërinë tonë akademike;
- Rritja e numrit të studentëve dhe studiuesve ndërkombëtarë në kampusin tonë.
- Zhvillimi i programeve të reja ndërkombëtare në gjuhën angleze;
- Zgjerimi i partneriteteve tona me agjencitë ndërkombëtare financuese në mbështetje të nismave kërkimore dhe akademike.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

4. Kërkimi shkencor, infrastruktura universitare, TI dhe digjitalizimi

Orientimi i Universitetit të Tetovës ka qenë dhe ngelet kah realizimi i aktiviteteve kërkimore-shkencore, përmirësimi dhe avancimi i infrastrukturës, TI-ja dhe digjitalizimi. Veprimtaria kërkimore-shkencore është bazamenti i zhvillimit bashkëkohor të universiteteve dhe matësi kryesor i arritjeve. Në vitet e kaluara Universiteti i Tetovës ka shënuar një progres të theksuar në zhvillimin e kërkimit shkencor, si organizimin e dy kongreseve vjetore ndërkombëtare (Kongresi Ndërkombëtar i Shkencave Natyrore, Mjekësore dhe Teknologjive dhe Kongresi Ndërkombëtar i Shkencave Humane, Sociale dhe Arteve). Gjatë dekadës së fundit janë botuar në vazhdimësi 11 revista shkencore të njësive të Universitetit me bord ndërkombëtar, të indeksuara në: Google Scholar, IndexCopernicus International, Academic Search Complete (EBSCO), CEEOL, EHRIPLUS, DOAJ dhe MLA International Bibliography & ISI Impact Factor, duke shfrytëzuar sistem elektronik për menaxhim me hulumtime shkencore (Open Access Journals following CC-BY licence; Peer review process; Using Ethical principles and rules of scientific honesty of the EASE (European Association of Scientific Editors)).

Organizimi i Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë dhe Revista ALBANOLOGJIA, anëtarësimi në EASE, organizimi i tryezave të rrumbullakëta, bashkëpunimi shkencor me ndërmarrjet ekonomike dhe industriale, organizimi i punëtorive për zhvillim profesional shkencor të stafit akademik, organizimi i simpoziumeve të ndryshme shkencore, promovime dhe botime të vazhdueshme të librave, ligjërata shkencore nga ligjërues të huaj, pjesëmarrja në projekte kërkimore-shkencore si ERASMUS+ KA2, COST, WBF, IPA/CBC, CEEPUS etj., qasje në rrjetin e botimeve elektronike COBISS, janë disa nga arritjet më të theksuara në këtë fushë.

Janë siguruar kushte për funksionimin e plotë të laboratorëve shkencorë edhe atë: laboratorë të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, laboratoritë i Fakultetit të Shkencave të Zbatuara (i akredituar për testim dhe kontroll të materialeve ndërtimore), laboratoritë i Institutit Ekologjik dhe Teknologjik për kërkime shkencore, laboratoritë i Psikologjisë, Parku Teknologjik APOLON, Qendra për Paqe dhe Komunikim Transkulturore, Institutit Ekologjik dhe Teknologjik, Institutit Josif Bageri, Klinika Juridike e regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë së RMV-së, fusha e disponueshme bujqësore.

Fushat me prioritet për përmirësim në të ardhmen do të jenë: rritja e numrit të projekteve kërkimore-shkencore, qasje më e madhe në bibliotekat elektronike të botimeve shkencore, përkrahje e vazhdueshme e stafit akademik për botime në revistat shkencore me faktor impakti si dhe mbështetje në laboratorët shkencorë.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Plani i veprimtimit në mandatin trevjeçar:

- Forcimi i kapaciteteve në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike;
- Krijimi i një fondi të posaçëm për hulumtime shkencore dhe rritja e përpjekjeve për të siguruar mjete buxhetore për veprimtarinë kërkimore-shkencore;
- Përpilimi i një skeme specifike financimi të mbështetjes së projekteve kërkimore-shkencore duke respektuar barazinë gjinore;
- Krijimi dhe përforcimi i infrastrukturës së laboratorëve të studentëve në të gjitha njësitë e Universitetit;
- Organizimi i konferencave tematike ndërdisiplinore ndërkombëtare;
- Mbështetja financiare e hulumtuesve shkencorë për botim në revista prestigjioze të indeksuara në WOS dhe SCOPUS;
- Përfshirja dhe mbështetja e studentëve në kërkime shkencore;
- Inkurajimi dhe mbështetja e kërkimit shkencor dhe avancimit postdoktoral;
- Indeksimi revistave të njësive akademike të Universitetit në SCOPUS;
- Akreditimi i laboratorëve shkencorë dhe zhvillimi i veprimtarisë së zbatuar;
- Furnizimi i vazhdueshëm i bibliotekës elektronike të Universitetit (eprints.unite.edu.mk);
- Qasja në biblioteka elektronike si: ELSEVIER, Cambridge University Publishing dhe MUSE;
- Rritja e numrit të aplikimeve për projekte ndërkombëtare, kryesisht në Horizon Europe dhe ERASMUS+ KA2;
- Forcimi i punës kërkimore ndërdisiplinore dhe formimi i ekipeve kërkimore ndërdisiplinore;
- Promovimi dhe zbatimi i konceptit të shkencës së hapur (Open Science);
- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe udhëzimeve kërkimore përkatësisht sjellja e akteve juridike dhe avancimi i atyre aktuale për veprimtari kërkimore-shkencore, siç janë: Rregullorja për punë kërkimore-shkencore në nivel të Universitetit, Rregullorja e punës dhe monitorimit të laboratorëve shkencorë, themelimi i Këshillit të Etikës Kërkimore;
- Forcimi i mbështetjes administrative për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- Qasja në rrjetet kërkimore/shkencore si WIDERA (Widening participation and strengthening European Research Area – Timing, European Excellence Initiatives, Excellence Hubs, Hop on Facility);
- Ndërlidhja e shkencave humane, sociale dhe arteve me njësitë STEM;
- Mbështetja e tezave hulumtuese në kontekstin e politikave aktuale të kërkimit dhe projekteve kërkimore-shkencore;
- Themelimi i instituteve paraklinike dhe klinike në Fakultetin e Shkencave Mjekësore;
- Krijimi i Qendrës për të dhëna (Data Center) në hapësirat e Universitetit dhe në Cloud.

Funksionalizimi i Parkut Teknologjik Apolon

Parku Teknologjik do të jetë një platformë e përshtatshme për inkubimin e startup-ëve të krijuar nga studentët dhe stafi akademik i Universitetit. Inkubimi i startup-ëve universitarë në Parkun Teknologjik mund të sjellë përfitime të mëdha për Universitetin, duke rritur lidhjet me industrinë dhe duke krijuar mundësi për punësim të studentëve.

Parku Teknologjik do të luajë rol kyç në transferimin e teknologjisë dhe njohurive nga Universiteti në sektorin e tregut. Përmes partneriteteve dhe bashkëpunimeve me kompanitë private, Universiteti mund të shfrytëzojë Parkun Teknologjik për të zhvilluar aplikime komerciale të teknologjisë dhe për të sjellë inovacione në treg, duke përmirësuar lidhjet me industrinë. Parku Teknologjik do të sigurojë hapësirë, në të cilën kompanitë e ndryshme do të punojnë dhe zhvillojnë projekte. Përmes partneriteteve me kompanitë, investimeve të jashtme dhe programeve të mbështetjes së inovacionit, Universiteti mund të përfitojë nga investimet e reja, duke u mundësuar të zhvillojnë më tej kërkimin, infrastrukturën dhe programet e tij të edukimit.

Organizimi i trajnimeve me palët e treta do të përfshijë zhvillimin e aftësive të reja teknike, njohjen e teknologjive të reja ose zbatimin e metodave të avancuara të punës. E njëjta do të ndihmojë në ndryshimin dhe modernizimin e sektorit privat. Përmes këtyre trajnimeve, kompanitë mund të mësojnë për teknologjitë e reja, metodologjitë inovative dhe zhvillimet e fundit në sektorin e tyre. Ndërtimi i rrjetit të kontakteve e hapin rrugën për partneritet të akademisë së biznesit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Avancimi i veprimtarisë kërkimore të instituteve

Instituti Ekologjik dhe Teknologjik mundëson qasje në entitetin global në mbajtjen e sistemeve të mbështetjes së jetës në tokë për mirëqenien njerëzore, prandaj orientimi do të jetë në rritjen e kapaciteteve për realizim të aktiviteteve të cilat sigurojnë përfitimin maksimal të ruajtjes së mjedisit për komunitetet lokale dhe globale. Po ashtu do të përqendrohemi në ofrimin e shërbimeve të konsulencës, edukimit dhe trajnimit në fushën mjedisore, sociale dhe ekonomike për palët e treta në mënyrë që të ruhet harmonia mjedisore, sociale, ekonomike si dhe në projekte kërkimore për mbrojtjen e florës dhe faunës në Malin Sharr.

Në periudhën e ardhshme trevjeçare do të angazhohemi edhe në rritjen e kapaciteteve të Institutit Josif Bageri për të trajtuar çështjet e memories dhe kujtesës historike në debatin publik, por edhe në zhvillimin e historiografisë kombëtare si element shumë i rëndësishëm në ruajtjen e identitetit tonë.

Përforcimi i kapaciteteve të shkollës së doktoraturës

Programet e doktoratës në vazhdimësi janë zhvilluar dhe përsosur duke përmbushur një sërë kriteresh, por është e rëndësishme të merret në konsideratë që puna kërkimore - shkencore gjithmonë ka qenë në rend të parë. Gjatë mandatit trevjeçar, fuqishëm do të punojmë të përmirësojmë më tej cilësinë e programeve dhe gjithashtu të ofrojmë një kornizë, e cila do të lehtësojë krijimin e më shumë programeve të doktoratës. Njëkohësisht do të fokusohemi në:

- Ngritjen e kapaciteteve kooperuese me biznesin dhe industrinë, të cilat si prioritet kryesor do të përfshijnë shfrytëzimin komercial të kërkimit në studimet e doktoraturës;
- Krijimin e programeve të përbashkëta të doktoratës me universitete të rajonit e më gjerë;
- Zhvillimin e infrastrukturës në përputhje me qëllimet dhe natyrën e programeve studimore të studimeve të doktoraturës;
- Krijimin e këshillave të studimeve të doktoraturës, për organizimin, përcjelljen, menaxhimin dhe monitorimin e cilësisë së studimeve doktorale.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

➤ **Infrastruktura universitare**

Infrastruktura është gjithashtu një komponent thelbësor i kushteve për arsim të lartë cilësor, në përmirësimin dhe avancimin e së cilës financat janë shtylla kryesore për realizimin e qëllimeve strategjike.

Do të intensifikojmë përpjekjet për rritjen e burimeve financiare nga buxheti i shtetit, me të vetmin qëllim që të sigurohen kushte për realizimin e qëllimeve strategjike që janë në frymën e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në fushën e investimeve kapitale. Kjo do të shërbejë për sigurimin dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore;

Në këtë kontekst, ndër prioritetet e mandatit trevjeçar, do të jetë sigurimi i standardeve dhe kapaciteteve përkatëse infrastrukturore të të gjitha njësive të Universitetit, përkatësisht, në objektet infrastrukturore të planifikuara janë të parapara:

- Mbështetja prioritare në ngritjen e kapaciteteve të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë përkatësisht objekt i ri dhe rinovimi i objektit ekzistues për Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë;
- Zgjerimi i objektit në Qendrën Urgjente për nevojat e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë;
- Ndërtimi i objektit për Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore;
- Biblioteka Universitare;
- Institutet kërkimore-shkencore për kineziologji, ekologji, filologji, histori, akademi futbollit, librari;
- Rikonstruksioni i stadiumit ekzistues të futbollit, pishinë e mbyllur dhe sallë e vogël sportive;
- Zgjerimi i objektit të destinuar për Fakultetin e Shkencave të Zbatuara etj.
- Investimi në sisteme të qëndrueshme për rritjen e efikasitetit energjetik dhe instalimi i burimeve të ripërtrishme të energjisë përkatësisht ndërtimi i centraleve diellore fotovoltaike etj.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

➤ TI dhe digjitalizimi

TI është departament kryesor në çdo organizatë që synon të ketë funksionalitet dhe suksese, me qëllim të rritjes së efikasitet dhe ndjekjes së trendeve bashkëkohore, që mbështesin vizionin dhe qëllimet në nivel institucional, përkatësisht digjitalizimin e tërësishëm institucional, duke aplikuar metodat, trendet dhe modelet më bashkëkohore. Si rezultat i kësaj, sot Universiteti posedon sisteme të avancuara digjitale siç janë: Sistemi Elektronik Universitar (LMS), Sistemi Elektronik për Menaxhim me Hulumtime Shkencore (RMS), Sistemi Elektronik për Menaxhim dhe Përpilim të Akreditimit të Programeve Studimore. Po ashtu posedon edhe numër të konsiderueshëm të pajisjeve teknologjike harduerike në të gjitha njësitet akademike.

Modernizimi dhe furnizim i vazhdueshëm me pajisje teknologjike i të gjitha njësive universitare përfshirë këtu edhe laboratorët e studentëve dhe sigurimi i infrastrukturës bazë (të re), duke përfshirë harduerë dhe softuerë përkatës, do të jenë prioritete në të cilat do të përqendrohemi në 3 vitet në vazhdim.

- Finalizimi i modulit të evidencës elektronike, nënshkrimit elektronik dhe diplomimit në kuadër të sistemit elektronik universitar,
- Krijimi i platformës elektronike për ALUMNI;
- Integrimi i modulit të evaluimit në sistemin elektronik universitar;
- Qasja në WIFI në gjithë kampusin universitar përmes instalimit dhe konfigurimit të Wireless Campus, për stafin akademik, administrativ, studentët dhe të gjithë vizituesit tjerë,
- Furnizimi i vazhdueshëm me pajisje të reja dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese;
- Konfigurimi dhe instalimi i IP telefonisë;
- Përgatitja dhe konfigurimi i rrjetit të kampusit për inkuadrim në platformat akademike si EDUROAM dhe EDUGAIN;
- Mbështetje në trajnime dhe licencime të vazhdueshme të ekipit profesional të qendrës për TI përkatësisht trajnimi i ekipeve, për të përballuar kompleksitetin e punëve.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

5. Përgjegjësia sociale dhe angazhimi me komunitetin

Universiteti i Tetovës e ka dëshmuar lidhjen e tij organike dhe të natyrshme me komunitetin. Si një brend i mirëstabilizuar në opinion, Universiteti i Tetovës edhe për nga historia është i lidhur fort me popullsinë shqiptare në trevat e Maqedonisë së Veriut. Përveç rolit të vetë edukativ-arsimor si një nga institucionet e arsimit të lartë, ka edhe përgjegjësi të tjera me karakter gjithëpërfshirës, të cilat kanë si qëllim gjetjen e zgjidhjeve ndaj problemeve ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke kontribuar në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Vetë misioni i Universitetit të Tetovës, i cili është krijimi dhe avancimi i të mësuarit, shkathtësive, njohurive, kompetencave akademike dhe profesionale, që do të jenë avancuese të ndryshimeve në shoqëri, në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, e bën atë një urë lidhëse mes elementeve kryesore të trekëndëshit të dijes: arsimim, kërkim shkencor, inovacion shkencor. Është pikërisht ky rol dhe pozicion unik që ka universiteti në shoqëri, që e bën atë prijës në rrugën drejt zhvillimeve inovatore qofshin ato lokale, kombëtare por edhe ndërkombëtare.

Për ta forcuar edhe me tej rolin e UT-së dhe përgjegjësinë e tij sociale ndaj komunitetit e më gjerë, është e nevojshme rritja e angazhimit me komunitetin, duke forcuar marrëdhëniet aktuale dhe zhvilluar marrëdhënie të reja. Si rrjedhojë, pritet që përkushtimi i vazhdueshëm të rezultojë me impakt pozitiv në shoqëri. Për arritjen e kësaj, gjatë këtij mandati trevjeçar, do të hartojmë dhe vëmë në zbatim disa plane veprimi për rritjen e angazhimit të UT-së me komunitetin. Më konkretisht, e shohim si të rëndësishme zhvillimin e partneriteteve të qëndrueshme me organizatat lokale, OJQ-të, aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata qeveritare, duke bashkëpunuar ngushtë për shkëmbim të ideve, burimeve, e deri në organizimin e projekteve të përbashkëta.

Universiteti do të angazhohet të jetë model për komunitetin dhe të kontribuojë për kujdesin mjedisor nëpërmjet praktikave të qëndrueshme për minimizim të impaktit negativ në mjedisin ekologjik. Veprimet e ndërmarra nga Universiteti do të reflektojnë përgjegjësi ndaj mjedisit edhe atë nëpërmjet kultivimit të mjedisit të gjelbër në kampus, instalimit të burimeve të ripërtrishme energjetike si dhe promovimin e programeve për riciklim. Në bashkëpunim me komunitetin lokal, por edhe me agjencitë qeveritare do të iniciojë nisma të përbashkëta të praktikave të qëndrueshme për të promovuar ekuilibër ekologjik afatgjatë dhe mirëqenie sociale.

Hapja e dyerve të Universitetit dhe ofrimi i hapësirave të përbashkëta për komunitetin, si shfrytëzimi i sallave të konferencave, i burimeve të bibliotekës, të sallave sportive, dhe ambienteve për kulturë për organizimin e aktiviteteve të bashkësisë, punëtorive, shfaqjeve kulturore dhe artistike do të jetë një ndër strategjitë që do të përdoren për ta bërë Universitetin e krijuar nga populli, të jetë me pranë dhe më i qasshëm për komunitetin.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Gjithashtu, do të vazhdojmë të organizojmë evente dhe ngjarje të hapura për publikun, krahas atyre me karakter shkencor si konferencat, seminarët, por edhe debate publike për trajtimin e temave frytdhënëse për shoqërinë e gjerë për të inkurajuar dialogun dhe pse jo edhe ndërgjegjësimin e komunitetit për çështje relevante.

Globalizimi si proces i paevitueshëm sjell me vete dobi dhe njëherësh edhe sfida të mëdha. Edhe pse jemi të përfshirë në këtë proces dhe mbi të gjitha jemi duke krijuar strategji për ndërkombëtarizimin e Universitetit, do të vazhdojmë të jemi të fokusuar në promovimin e vlerave dhe jetësimin e idealeve kombëtare në arsim, shkencë e kulturë. Gërshetimi i ngushtë i vizionit dhe qëllimeve të Universitetit me vlerat kombëtare është dëshmuar dhe do të vazhdojë të dëshmohet nga rëndësia e veçantë që i kushtohet përshfaqjes së këtyre vlerave. Promovimi artit dhe i kulturës në përgjithësi, por sidomos i artit dhe kulturës kombëtare shqiptare, është i rrënjësor thellë në kolonat ndërtuese të Universitetit. Gjatë këtij mandati trevjeçar, do t'i jepet theks i veçantë përpilimit të planeve të punës për organizimin dhe realizimin e aktiviteteve që kanë për qëllim promovimin e artit dhe kulturës kombëtare, si shënimi i datave me rëndësi të veçantë historike dhe kombëtare, hapja e ekspozitave për promovimin e artistëve shqiptarë, promovimi i veprave artistike, realizimi i bashkëpunimeve në rrafshin mbarëshqiptar.

Gjatë mandatit trevjeçar do të maksimalizohet investimi për ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë historike dhe kulturore të Universitetit, si objektet e ofruara nga qytetarët si mësonjëtoje të para gjatë themelimit të Universitetit të Tetovës, konzervimin e materialeve historike dhe Muzeut të Universitetit. Gjithashtu kujdes i veçantë do u kushtohet Dëshmorit të Arsimit Abdylselam Emini, Themeluesit dhe Rektorit të parë, Prof.Dr Fadil Sulejmani dhe dëshmorëve të tjerë, njëherësh edhe ndaj të gjithë komunitetit që ka kontribuar në funksionalizimin e Universitetit prej ditëve të para e në vazhdim.

Në misionin tonë për të promovuar dhe inkurajuar dialogun nëpërmjet aktiviteteve dhe debateve publike, do të mund të realizojmë promovimin e vlerave evropiane dhe të angazhohemi në demokratizimin e shoqërisë. Duke shërbyer si shembull për promovimin e lirisë së fjalës dhe të mendimit, lirisë akademike, lirisë për të hulumtuar, gjithmonë duke iu përmbajtur vlerave të etikës, do të mund të shtrojmë bazat për ndërtimin e një shoqërie civile aktive, të brumosur me frymën e tolerancës, të aftësuar për të menduar në mënyrë kritike, që respekton barazinë dhe diversitetin. Rrugëtimi ynë për t'ju shtuar platesë së vendeve të Bashkimit Evropian është ende i papërfunduar, por që në të ardhmen pritet të bëhet realitet, ndaj ngulitja e vlerave evropiane në shoqërinë tonë është një domosdoshmëri e kohës, për të formuar qytetarët evropianë të së ardhmes.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Hartimi dhe zhvillimi i programeve për përfshirjen e komunitetit është një pikë tjetër në planin aksionar për të forcuar pozitën e UT-së në shoqëri. Programe të tilla do të kenë për qëllim ofrimin e ekspertizës në fusha të ndryshme në ndihmë të nevojave dhe të përballimit të sfidave me të cilat mund të përballet komuniteti, në realizimin e të cilave mund të përfshihen jo vetëm stafi profesional e akademik, por edhe studentët. Duke filluar që nga shërbimet e konsulencës, trajnime dhe seminare, projekte shoqërore dhe humanitare por edhe projekte të tjera, si organizimi i fushatave sensibilizuese, aktivitete të ndryshme me impakt social, për të cilat tashmë është krijuar një traditë (shënimi i ditës së shëndetësisë, aksione të dhurimit të gjakut, aksione humanitare, etj).

Si një qendër e dijes, është thelbësore për ne si Universitet të jemi të përfshirë në mënyrë aktive në krijimin e politikave strategjike me interes kombëtar dhe shtetëror, duke i ofruar kapacitetet të cilat i zotërojmë, si:

- profesorë të mirafirmuar dhe ekspertë të fushave të ndryshme,
- mundësi për realizimin e hulumtimeve të specializuara dhe analizave të thelluara në fusha të caktuara, rezultatet e të cilave mund të shërbejnë më pas si bazë për hartimin e planeve strategjike dhe politikave të ndryshme të vendimmarrjes,
- mundësi shkëmbimi të ideve mes ekspertësh dhe eksperiencave të ndryshme në nivel ndërkombëtar nëpërmjet organizimit të simpoziumeve, kongreseve, konferencave dhe bashkëpunimeve të tjera me synimin e përbashkët në shpалosjen e rezultateve të bazuara në ekspertizën e specializuar.

Realizimi dhe krijimi i të gjitha kushteve të nevojshme për hapjen e radios së Universitetit është një ndër prioritetet e këtij mandati. Radioja e Universitetit do të vihet në shërbim të katedrës së gazetarisë dhe do të shërbejë si një “laborator” praktik për studentët, dhe përveç të tjerave, do të rrisë angazhimin e institucionit me komunitetin lokal. Përveç radios, do të angazhohemi edhe në hapjen e TV në internet, për realizimin e të cilit do të bashkëveprojnë disa fakultete, për t'u ardhur në ndihmë studentëve të gazetarisë, regjisë, montazhit, aktrimit, etj. për realizimin e punës praktike dhe përfitimit të eksperiencave të vlefshme të punës. Gjithashtu, gjatë këtij mandati, do të realizojmë botimin e gazetës mujore të Universitetit, të cilën e konsiderojmë një mundësi të mirë jo vetëm për stafin, por edhe për studentët.

Themelimi i Kopshtit Universitar për edukim parashkollor në kuadër të Fakultetit Pedagogjik me programe dhe metoda më të avancuara, i cili do të ofrojë mundësinë e shfrytëzimit të qëndrimit tërëditor për fëmijët e moshës parashkollore.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Gjatë tre viteve të ardhshme do të themelohet dhomë terapeutike (*dhomë sensorike, dhomë terapeutike, kabinet audiologjik dhe logopedi*) për edukim praktik të studentëve, nëpërmjet terapive individuale, grupe me fëmijët me nevoja të veçanta, për fëmijë me çrregullime të spektrit autik, ata me dëmtime të shikimit, me çrregullime në zhvillimin motorik dhe vështirësitë e të nxënit. Në këtë mënyrë do të ofrojmë mundësi për mbështetje të grupeve vulnerable të komunitetit tonë – familjet me fëmijë me vështirësi në zhvillim.

Universiteti i Tetovës do të vazhdojë të investojë në infrastrukturë, mbështetje financiare, pajisje e teknologji dhe ekspertizë në qendrat të cilat veçmë funksionojnë. Në Qendrën për paqe dhe komunikim transkulturore do të rriten kapacitetet e hulumtimeve të pavarura të politikave publike në fushën e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare, ndërsa në Qendrën për gjuhë të huaja do të ofrohen mundësi aftësimi dhe/ose avancimi në gjuhë të ndryshme, për studentë, staf akademik dhe mbarë komunitetin, si dhe mundësi lehtësimi të qasjeve për testime ndërkombëtare. Në vazhdimësi do të themelojmë Qendrën për arsimimin e të rriturve dhe trajnimeve për zhvillim profesional, e cila do të jetë bartëse e reformave dhe ndryshimeve në arsim dhe fushave tjera profesionale.

Arritja e qëllimeve dhe objektivave të prioritetëve strategjike të Programit të punës së Rektorit, për periudhën 2023-2026, do të përcaktohet në bazë të përpilimit të planeve aksionare duke i caktuar realizuesit, aktivitetet dhe afatin e realizimit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

III. Përfundimi

Universiteti i Tetovës nëpërmjet qasjes holistike dhe bashkëpunuese me gjithë komunitetin akademik, studentët, stafin akademik dhe stafin administrativ e teknik, si dhe palët e interesuara, do të vazhdojë të ngelë i fokusuar në realizimin e vizionit të tij - Jetësimin e idealeve kombëtare dhe vlerave bashkëkohore në arsim, shkencë, kulturë me qëllim të zhvillimit dhe përparimit të gjeneratave të ardhshme.

Gjatë tre viteve të ardhshme një ndër prioritetet tona do të jetë përcaktimi i qëllimit gjithëpërfshirës dhe afatgjatë i Universitetit duke siguruar që të gjitha nismat dhe vendimet të mbështesin vlerat thelbësore të institucionit tonë. Përmes ndërtimit të strategjisë dhjetëvjeçare do të harmonizohen aktivitetet që do të ndërmerren në të ardhmen me vizionin e Universitetit. Barazia gjinore, gjatë trevjeçarit të ardhshëm do të ketë trajtim dhe përfshirje transversale, e adresuar në të gjitha prioritetet strategjike.

Duke pasur si prioritet krijimin e një kulture të përmirësimit dhe avancimit të vazhdueshëm në arsim, gjatë tre viteve të ardhshme mbështetja e vazhdueshme do të orientohet drejt zhvillimit akademik të stafit e studentëve dhe lirisë akademike. Për këtë qëllim do të ofrohen programe, seminare dhe punëtori për zhvillim kompetencash profesionale për të qenë të përditësuar me praktikatat më të mira në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, por edhe diseminimit të përvojave akademike.

Synimi ynë do të vazhdojë të jetë plotësimi i vendeve të punës me kuadër të përshtatshëm akademik dhe avancimi në thirrje mësimore-shkencore.

Studentët do të ngelin partneri ynë më i fuqishëm gjatë tre viteve të ardhshme duke përforcuar përfshirjen e tyre në organet vendimmarrëse të Universitetit dhe në krijimin e kurrikulave mësimore që si rrjedhojë se bashku të krijojmë një mjedis mbështetës që nxit gjithëpërfshirjen, diversitetin e ndjenjën e përkitjes. Përforcimi i kapaciteteve për karrierë, funksionimi i asociacionit ALUMNI, shkëmbimi i përvojave me universitete jashtë vendit nëpërmjet programeve të ndryshme, përfshirja në aktivitete kulturore e sportive, aktivitete jashtëmësimore, mësimi tutorial, ofrimi i programeve orientuese gjithëpërfshirëse, vazhdimi i mbështetjes me bursa, ofrimi i shërbimeve mjekësore përmes poliklinikës studentore, rritja e mundësive për pjesë praktike në laboratorë të Universitetit dhe në institucione përkatëse do të sigurojnë rritjen e standardit studentor dhe krijimin e një mjedisi që promovon përsosmëri akademike, zmadhon shkathhtësitë praktike dhe zhvillimin profesional.

Ndërkombëtarizimi, duke nxitur kompetenca globale, shton vlerën e Universitetit, rrit cilësinë në arsim, promovon kërkimin dhe inovacionin si dhe gjeneron përfitime ekonomike, që bën të jetë një ndër prioritetet e rëndësishme në trevjeçarin e ardhshëm.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Zgjerimi i partneriteteve dhe bashkëpunimeve me universitetet tjera dhe promovimi i mobilitetit e programeve të shkëmbimit përveç se do të na ofrojë promovim të kuptueshmërisë ndërkulturore, dialogut dhe respektit të ndërsjellë, njëkohësisht do të mundësojë që komuniteti ynë akademik të avancojë njohuritë për të adresuar sfidat shoqërore si dhe për të përgatitur studentët për një botë të globalizuar.

Gjatë tre viteve të ardhshme do të vazhdojmë të mbështesim aktivitete kërkimore-shkencore duke siguruar infrastrukturë të qëndrueshme dhe duke rritur burimet e teknologjisë, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe udhëzimeve kërkimore për të mundësuar që studiuesit t'i artikulojnë gjetjet e tyre në aplikime praktike. Funksionalizimi i plotë i parkut teknologjik do të jetë pikësynimi ynë për vitet vijuese.

Objektivi ynë ngelet digjitalizimi i plotë si dhe investimet për të mundësuar shfrytëzim efektiv të TI-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, për të rritur aftësitë kërkimore të stafit dhe studentëve si dhe për të optimizuar proceset administrative.

Universiteti i Tetovës do të vazhdojë në trevjeçarën e ardhshëm të forcojë marrëdhëniet aktuale dhe të zgjerojë partneritete të qëndrueshme me komunitetin, organizatat joqeveritare, qeveritare, lokale dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile. Krahas promovimit të artit dhe kulturës në përgjithësi si dhe promovimit të vlerave shoqërore, do të vazhdojmë të jemi të angazhuar në promovimin e lirisë së fjalës dhe nxitjes së aftësimin të mendimit kritik me qëllim të ndërtimit të shoqërisë civile aktive.